
	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	PR-MO-
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 1 nga 19</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

**Operatori i Sistemit të
Transmisionit dhe Tregut të Kosovës
(KOSTT)**

**Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin
Financiar**

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 2 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Kjo procedurë e **Rregullave të Tregut** (duke përfshirë edhe amendamentet e mëvonshme) është përpiluar në përputhje me paragrafin 8.1.2 të **Rregullave të Tregut** që janë përgatitur në përputhje me Nenin 23 (paragrafi 7) të Ligjit Nr. 05/L -085 për Energjinë Elektrike.

Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar

1 Objektivat dhe Fushëveprimi

1.1 Objektivat

1.1.1 Në përputhje me paragrafin 8.1.1 të **Rregullave të Tregut**, para se një **Palë Tregtare** të mund të dorëzojë **Nominimet Kontraktuale, Nominimet Fizike, Ofertat për Shitje dhe Ofertat për Blerje** sipas **Rregullave të Tregut**, **Pala** duhet të dëshmojë që ka **Garancionin Financiar** adekuat të bërë në favor të **OT**. Kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut** shërben për të përcaktuar se sa duhet të jetë vlera e këtij **Garancioni Financiar** dhe si mund të përcaktohet mjaftueshmëria e tij.


1.2 Fushëveprimi

1.2.1 Siç specifikohet në paragrafin 8.1.2 të **Rregullave të Tregut**, kjo **Procedurë e Rregullave të Tregut** për **Garancionin Financiar** do të mbuloj:

- (a) kalkulimin e vlerës së **Garancionit Financiar** që **Pala Tregtare** duhet pa tjetër ta mirëmbaj;
- (b) dëshminë që **Garancioni Financiar** është deponuar në favor të **OT**;
- (c) monitorimin e mjaftueshmërisë së **Garancionit Financiar**;
- (d) kërkesat për rritjen ose zvogëlimin e vlerës së **Garancionit Financiar** të **Palës Tregtare**; dhe
- (e) kufizimin e aktiviteteve të **Palës Tregtare** kur **Garancioni Financiar** nuk është adekuat.

1.2.2 Për më tepër, **OT**-ja do të kërkojë **Garancion Financiar** për të siguruar pagesën e tarifave të tjera të parashikuara sipas **Rregullave të Tregut**, përkatësisht:

- (a) Detyrimin e Prodhuesit për shfrytëzim të rrjetit të transmetimit;
- (b) Detyrimin e Prodhuesit për Operim të Sistemit;
- (c) Detyrimin e Prodhuesit për Operim të Tregut;
- (d) Detyrimin e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit;
- (e) Detyrimin e Furnizuesit për Operim të Sistemit;
- (f) Detyrimin e Furnizuesit për Operim të Tregut;
- (g) Pagesat e Furnizuesit për Fondin Mbështetës për BRE;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 3 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

(h) Pagesat e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE që nuk kanë kontratë për diferencë për energjinë e blerë nëpërmjet ALPEX.

1.3 Termet e përdorura në këtë Procedurë të Rregullave të Tregut

1.3.1 Termet vijuese do të përdoren në këtë **Procedurë të Rregullave të Tregut**:

- (a) **Regjistri i Garancionit Financiar** është regjistri i instrumenteve të **Garancionit Financiar** që mirëmbahet nga **OT**;
- (b) **Çmimi Sigurues i Jobalancit** është çmimi i përdorur nga **OT** për kalkulimin e vlerës minimale të **Garancionit Financiar** që çdo **Palë Tregtare** duhet ta ketë.
- (c) **Garancioni Financiar** për jobalancë është niveli minimal i llogaritur i **Garancionit Financiar** që kërkohet nga **Pala Tregtare** ose **PPB** për jobalancet e tyre.

1.3.2 Të gjitha termet tjera në bold do të kenë kuptimin e dhënë në Rregullat e Tregut dhe legjislacionit në fuqi.

1.3.3 Çdo term tjetër ligjor do të jetë i dhënë në Ligjet relevante.


2 Regjistri i Garancionit Financiar Minimal

2.1 Krijimi i Regjistrimit

2.1.1 Në përputhje me paragrafin 8.3.2 të **Rregullave të Tregut**, **OT** do të krijojë një regjistër (**Regjistrin e Garancionit Financiar**) të instrumenteve të **Garancionit Financiar** të deponuara në përputhje me Nenin 4 të kësaj procedure.

2.1.2 **Regjistri i Garancionit Financiar** do të përfshijë detajet e plota të çdo instrumenti të **Garancionit Financiar** që aktualisht është deponuar nga një **Palë Tregtare** duke përfshirë:

- (a) për çdo **Palë Tregtare**:
 - (i) vlerën minimale të **Garancionit Financiar** të kërkuar;
 - (ii) Vlerën e **Garancionit Financiar** që është deponuar, e cila duhet të jetë e disponueshme së paku deri në datën e cila është 30 ditë pas dorëzimit të faturës së ardhshme nga **OT**;
- (b) për çdo instrument të regjistruar nga ana e një Pale Tregtare:
 - (i) identitetin e **Palës Tregtare**;
 - (ii) llojin e instrumentit financiar;
 - (iii) institucionin që garanton instrumentin financiar (ose në rastin e parave të gatshme, Llogarinë e Mirëbesimit në të cilin është deponuar instrumenti financiar);
 - (iv) datën e skadimit të instrumentit financiar;
 - (v) vlerën e deponuar (në Euro).

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 4 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

2.2 Mirëmbajtja e Regjistrit

2.2.1 Së paku një here në muaj në kohën kur të jenë kryer të gjitha pagesat e borxheve ndaj **OT**, **OT** do të bëjë azhurnimin e **Regjistrit të Garancionit Financiar** me informata të reja në lidhje me instrumentet e **Garancionit Financiar** të deponuara nga ana e **Palëve Tregtare**.

2.2.2 Kur një **Palë Tregtare** beson se informatat e mbajtura në **Regjistrin e Garancionit Financiar** janë jo-korrekte, **Pala Tregtare** do ta njoftoj **OT** për këtë fakt dhe **OT** do ta shqyrtoj dhe ku është e nevojshme do të bëjë azhurnimin e **Regjistrit të Garancionit Financiar** dhe do ta njoftoj **Palën Tregtare** për ndryshimet eventuale.

2.2.3 Sipas diskrecionit të vet, **OT** mund, në çdo kohë, të pyesë një institucion që ka siguruar një instrument të **Garancionit Financiar** të bërë në favor të **OT**-së për vlefshmërinë të këtij instrumenti dhe kur **OT** beson që informatat në **Regjistrin e Garancionit Financiar** nuk janë korrekte do të bëjë azhurnimin e **Regjistrit të Garancionit Financiar** dhe të njoftoj **Palën Tregtare** e cila ndikohet nga rrethanat e krijuara.

2.3 Qasja në Regjistër

2.3.1 Brenda një **Dite të Punës** pas kërkesës së dorëzuar nga një **Palë Tregtare**, **OT** do ta njoftoj këtë **Palë Tregtare** për të gjitha informatat e mbajtura në **Regjistrin e Garancionit Financiar** që i përkasin asaj **Pale Tregtare**.

2.3.2 Me kërkesën e ofruesit të instrumentit të **Garancionit Financiar**, **OT** do ti kumtoj kësaj pale detajet e mbajtura në **Regjistrin e Garancionit Financiar** në lidhje me atë instrument.

2.3.3 Me përjashtim të rasteve të specifikuara në paragrafët 2.3.1 dhe 2.3.2, **OT** do të ruaj konfidencialitetin e informatave të mbajtura në **Regjistrin e Garancionit Financiar**.


3 Kalkulimi i vlerës së Garancionit Financiar të Palës Tregtare

3.1 Llogaritja e Çmimit Sigurues të Jobalancit

3.1.1 Për muajin e parë pas miratimit të kësaj Procedure të **Garancionit Financiar**, **OT** do të kalkulojë çmimin mesatar të jobalanceve në 12 muajt e kaluar dhe do të përzgjedhë këtë çmim si **Çmim Sigurues të Jobalancit**.

3.1.2 Në të gjithë muajt tjerë, **OT** do të kalkulojë mesataren e thjeshtë të **Çmimeve të Jobalancit** të regjistruara për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** për muajin e sapo përfunduar kalendarik dhe, në qoftë se mesatarja e thjeshtë e Çmimeve të Jobalancit është më e lartë se **Çmimi Sigurues i Jobalancit**, **OT** do të përdor këtë çmim të kalkuluar të zëvendësoj **Çmimin Sigurues të Jobalancit** aktual dhe për këtë do të njoftoj ZRrE-në.

3.1.3 Në qoftë se sipas paragrafit 3.1.2, çmimi më i lartë duhet ta zëvendësoj **Çmimin Sigurues të Jobalancit** ekzistues, atëherë **OT** do të bëjë ri-kalkulimin e vlerës minimale të **Garancionit Financiar** që kërkohet nga çdo **Palë Tregtare** dhe do ti njoftoj ato që vlera minimale e ri-kalkuluar e **Garancionit Financiar** do të aplikohet nga **Perioda e Barazimit Përfundimtar** e parë e muajit kalendarik që fillon [3] muaj pasi që **OT** ti ketë njoftuar ato për ndryshimin ose në një kohë më të hershme ose më të mëvonshme në varësi të udhëzimit të ZRRE-së.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 5 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.1.4 Pavarësisht nga ndryshimet në vlerën minimale të **Garancionit Financiar** parashikuar në paragrafin 3.1.3, çdo Tetor, OT do të përcaktoj **Çmimin Sigurues të Jobalancit** në konsultim me **ZRRE**, çmim i cili duhet të aplikohet nga **Perioda** e parë e **Barazimit Përfundimtar** në Janar të vitit të ardhshëm, dhe do të përdorë këtë çmim për ri-kalkulimin e vlerës minimale të **Garancionit Financiar** për çdo **Palë Tregtare** dhe do të njoftoj çdo **Palë Tregtare** për nivelin minimal të **Garancionit Financiar** të kërkuar nga Janari i ardhshëm.

3.1.5 **OT** do të publikoj në faqen elektronike të tij:

- (a) **Çmimin Sigurues të Jobalancit** aktual; dhe
- (b) Çdo **Çmim Sigurues të Jobalancit** të reviduar që duhet të aplikohet në të ardhmen dhe data nga e cila do të aplikohet ky çmim.

3.2 Përqindja minimale e jobalanceve negative dhe korrigjimi për Tregtarët në përqindje


3.2.1 **OT** do të konsultohet me **ZRRE** në lidhje me përqindjen minimale të jobalanceve negative të energjisë (*Jobalanceve-negative %*) që duhet të merren parasysh gjatë kalkulimit të arsyeshëm të nivelit minimal të **Garancionit Financiar** për çdo **Palë Tregtare** por nuk do të lejoj që kjo vlerë të bie nën [2.5%]. **OT** dhe **ZRRE** janë të autorizuar të vlerësojnë mundësinë që një **Palë Tregtare** mund të jetë në jobalanc negativ në të ardhmen përfshirë këtu edhe palët historiku i jobalanceve të të cilave tregon se nuk kanë qenë ndonjëherë në të kaluarën në jobalanc negativ; prandaj, përqindja minimale e jobalanceve mund të përcaktohet për të garantuar që çdo **Palë Tregtare** gjithmonë e mbanë një vlerë të **Garancionit Financiar**.

3.2.2 **OT** do të konsultohet me **ZRRE** në lidhje me mundësinë që një **Palë Tregtare** me **Funksion Pjesëmarrës të Konsumatorit me Shumicë** ka më shumë gjasa të jetë në jobalanc negativ ma pak ose më shumë se sa një **Furnizues** i zakonshëm, prandaj do të caktoj një tregtari korrigjimin në përqindje (*Korrigjimi për Tregtarin në %*). Për evitimin e dyshimeve, një **Konsumator me Shumicë** që vepron si pale kontraktuale në Bursë të Energjisë do të caktohet *Korrigjimi për Tregtarin në %* sa më afër 0% për të reflektuar gjasën shumë të vogël që Bursa e Energjisë të jetë në jobalanc që do të shkaktonte që vlera minimale e **Garancionit Financiar** të jetë afër zeros por nga **Konsumatorët** e tjerë me shumicë mund të kërkohej që *Korrigjimi për Tregtarin në %* të jetë afër 100% duke reflektuar mundësinë që edhe **Konsumatori me Shumicë** ka gjasë të jetë në jobalanc negativ aq sa edhe **Furnizuesit** e zakonshëm.

3.3 Garancioni Financiar Minimal për Furnizuesit

3.3.1 Çdo vit, gjatë muajit Tetor, **OT** do të konsultohet me **Operatorin e Sistemit, OSSH, Furnizuesit** dhe **ZRRE** për vlerën ET_v , që është konsumi total i prituri i energjisë elektrike në Kosovë në vitin që fillon në ditën e parë të Janarit të ardhshëm.

3.3.2 Një herë në vit, **OT** do të kalkuloj përpjesën në përqindje të çdo **Furnizuesi** nga marrja totale ($ETNjF_A$) si shumë e **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** në vitin e kaluar për **Sistemin Matës** që i është alokuar këtij **Furnizuesi** në krahasim me shumën totale të **Energjisë së Matur të Njesisë Furnizuese** të të gjithë **Furnizuesve** për periodën e njëjtë. Për shmangien e dyshimit, **OSSH**-ja do të trajtohet si **Furnizues** për qëllimin e prokurimit të Humbjeve të Shpërndarjes dhe rrjedhimisht, **OSSH**-ja duhet të sigurojë **Garancion Financiar** në favor të **OT**-së sipas kësaj **Procedure të Rregullave të Tregut**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 6 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.3.3 OT do të kalkuloj për çdo Furnizues "A" vlerën minimale të **Garancionit Financiar të Jobalancit** (XGF_A) me formulën:

$$EJ_{Ay} = \text{Max} \left(\frac{\sum_j EJB_{Aj}}{\sum_j EMD_{Aj}} \cdot \text{jobalancet negative \%} \right)$$

$$XGF_A = ET_y * ETNjF_A * \text{ÇSJ} * EJ_{Ay} * [12.5\%]$$

ku:

EJ_{Ay} është përpjesa e energjisë vjetore e jobalancit negativ të **Furnizuesit** në vitin e kaluar.

EJB_{Aj} është **Jobalanci i Energjisë** në **Llogarinë Dalëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** të vitit të kaluar i kalkuluar në përputhje me paragrafin 16.5.4 të **Rregullave të Tregut**;

EMD_{Aj} është **Energjia e Matur** në **Llogarinë Dalëse** për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar **"j"** të vitit të kaluar e kalkuluar në përputhje me paragrafin 16.5.4 të Rregullave të Tregut;

jobalancet negative % është përqindja minimale e jobalanceve negative e kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.2.1;

ET_y është konsumi total vjetor i pritur i energjisë elektrike në Kosovë i parashikuar në përputhje me paragrafin 3.3.1;

$ETNjF_A$ është përpjesa vjetore e ET_y e kalkuluar në përqindje e që i atribuohet **Furnizuesit "A"** në përputhje me paragrafin 3.3.2;

ÇSJ është **Çmimi Sigurues i Jobalancit** aktual.

3.3.4 OT-ja do të llogarisë nivelin minimal të **Garancionit Financiar** për çdo Furnizues "A", për çdo muaj "m", i cili do të llogaritet si shuma e:

(a) **Garancionit Financiar për Jobalance**;


(b) Detyrimit mujor të Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.3.7 të **Rregullave të Tregut**;

(c) Detyrimit mujor të Furnizuesit për Operatorin e Sistemit të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.4.4(c) të Rregullave të Tregut;

(d) Detyrimit mujor të Furnizuesit për Operatorin e Tregut të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.5.4(c) të **Rregullave të Tregut**;

(e) Pagesat e Furnizuesit për Fondin Mbështetës për BRE të llogaritur në përputhje me paragrafin 16.6.1 të **Rregullave të Tregut**;

(f) Pagesat e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE që nuk kanë kontratë për diferencë për energjinë e blerë nëpërmjet ALPEX të llogaritur në përputhje me paragrafin 16.6.1 të **Rregullave të Tregut**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 7 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.3.5 Për të shmangur dyshimin, niveli minimal i **Garancionit financiar** për OSSH-në do të llogaritet si shumë e **Garancionit Financiar të Jobalancit**, Detyrimit për Pagesë të Operimit të Sistemit dhe Detyrimit për Operim të Tregut.

3.4 Garancioni Financiar Minimal për Prodhuesit

3.4.1 Një herë në vit, në muajin Tetor, OT do të kalkuloj për të gjitha **Njësitë Gjeneruese "b"** të regjistruara në një **Llogari të Injektimit "A"** energjinë totale të prodhuar dhe do ta krahasoj këtë me energjinë totale të parashikuar në mënyrë që të kalkulohet jobalanci negativ i prodhuesit (EJ_{Ay}) dhe faktori i ngarkesës mesatare (FN_{Ay}) për **Njësitë Gjeneruese** në **Llogari të Injektimit**:

(a) në vitin e parë të operimit të **Prodhuesve** të ri në veçanti do të konsiderohet faktori mesatar i ngarkesës (FN_{Ay}) që do të marrë parasysh standardet ndërkombëtare të aplikuara për njësi të reja gjeneruese të ngjashme;

(b) OT do të kalkulojë përpjesën e energjisë së jobalancit EJ_{Ay} për vitin e kaluar me formulën:

$$EJ_{Ay} = \text{Max} \left(\frac{-\sum_j EJB_{Aj}}{\sum_j EMI_{Aj}}, \text{jobalancet negative \%} \right)$$

$$FN_{Ay} = \frac{\sum_j EMI_{Aj}}{XRrP_A * 8760}$$

ku:

EJ_{Ay} është përpjesa e energjisë vjetore e jobalancit negativ të Prodhuesit në vitin e kaluar, e cila, për të shmangur dyshimin, do të jetë 2.5% kur zbatohet paragrafi 3.4.1(a);


EJB_{Aj} është **Jobalanci i Energjisë** në **Llogarinë e Injektimit** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** të vitit të kaluar i kalkulluar në përputhje me paragrafin 16.5.3 të **Rregullave të Tregut**;

EMI_{Aj} është **Energjia e Matur** në **Llogarinë e Injektimit** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"** të vitit të kaluar e kalkulluar në përputhje me paragrafin 16.5.3 të **Rregullave të Tregut**;

jobalancet negative% është përqindja minimale e jobalancit negativ kalkulluar në përputhje me paragrafin 3.2.1 dhe për të shmangur dyshimin, do të jetë 2.5% ku zbatohet paragrafi 3.4.1(a);

$XRrP_A$ është total **Kapaciteti i Rrjetit për Prodhuesin** për **Llogarinë e Injektimit "A"**.

3.4.2 OT do të kalkuloj për çdo **Llogari të Injektimit "A"** nivelin minimal të **Garancionit Financiar për Jobalance** (XGF_A) nëpërmes formulës:

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 8 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

$$XGF_A = FN_{Ay} * XRRP'_A * \text{ÇSJ} * EJ_{Ay} * [12.5\%]$$

ku:

- FN_{Ay} është faktori mesatar i ngarkesës së **Njësive Gjeneruese** të regjistruara në **Llogari e Injektivit "A"** i kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.4.1;
- $XRRP'_A$ është totali i pritur i **Kapacitetit të Rrjetit për Prodhuesin** për vitin e parashikuar për **Llogarinë e Injektivit "A"**;
- ÇSJ është **Çmimi Sigurues i Jobalancit** aktual.
- EJ_{Ay} është përpjesa e energjisë vjetore të jobalancit negativ të **Prodhuesit** në vitin e kaluar e kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.4.1.

3.4.3 OT-ja do të llogarisë nivelin minimal të **Garancionit Financiar** për çdo Gjenerues "A", për çdo muaj "m", e cila do të llogaritet si shuma e:


- (a) **Garancionit Financiar** për Jobalance;
- (b) Detyrimit mujor të Prodhuesit për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.3.6 të **Rregullave të Tregut**;
- (c) Detyrimit mujor të Prodhuesit për Operim të Sistemit të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.4.4(a) të **Rregullave të Tregut** ose, sipas rastit, Detyrimit mujor për Operim të Sistemit të Prodhuesit në Shpërndarje të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.4.4(b) të Rregullave të Tregut;
- (d) Detyrimit mujor të Prodhuesit për Operatorin e Tregut të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.5.4(a) të **Rregullave të Tregut** ose, sipas rastit, Detyrimit mujor për Operim të Tregut të Prodhuesit në Shpërndarje të llogaritur në përputhje me paragrafin 17.5.4(b) të Rregullave të Tregut.

3.5 Garancioni Financiar Minimal për Tregtarët

3.5.1 Për plotësimin e kërkesave të paragrafit 8.2.1(c)(ii) të **Rregullave të Tregut**, OT do të bëjë regjistrimin kumulativ të energjisë EKT_A , që paraqet shumën e **Nominimeve Kontraktuale** (EK_{Anj}) të çdo **Furnizuesi me Shumicë "A"** ku një **Nominim Kontraktual** i tillë "n" në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"** ka parashenjën negative (që tregon se **Furnizuesi me Shumicë** është duke pranuar energji).

3.5.2 Për nevoja të kalkulimit të nivelit minimal të **Garancionit Financiar**, OT do të bëjë azhurnimin e regjistrimeve të **Nominimeve Kontraktuale** të **Konsumatorit me Shumicë** në fund të çdo muaji kalendarik.

3.5.3 OT do të përdorë informatat nga 12 muajt e fundit për **Nominimet Kontraktuale** të referuara në paragrafin 3.5.1 ose përndryshe do të përdorë **Nominimet Kontraktuale** relevante që janë dorëzuar nga **Konsumatori me Shumicë** në rastet kur janë në disponim informatat nga më pak se 12 muaj.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 9 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.5.4 Për çdo **Llogari të Injektimit** ose (si mund të jetë rasti) **Llogari Dalëse të Konsumatorit me Shumicë "A"**, OT do të kalkulojë nivelin minimal të **Garancionit Financiar** (XGF_A) me formulën:

$$XGF_A = -EKT_A * \text{ÇSJ} * \text{jobalancet negative\%} * \text{Korrigjimet për Tregtarin\%} * [12.5\%]$$

ku:

EKT_A është shuma kumulative e **Nominimeve Kontraktuale** të një **Konsumatorit me Shumicë** e kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.5.1;

ÇSJ është Çmimi Sigurues i Jobalancit aktual.

jobalancet negative% është përqindja minimale e jobalanceve negative e kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.2.1;

korrigjimi për Tregtarin% është korrigjimi në përqindje e dakorduar me **Rregullatorin** dhe i kalkuluar në përputhje me paragrafin 3.2.2 që reflekton probabilitetin relativ që një **Konsumatorit me Shumicë** të jetë në jobalanc në krahasim me probabilitetin që një **Furnizues** i zakonshëm të jetë në jobalanc.

3.6 Garancioni Financiar Minimal për Tregtarët Ndërkufitar

3.6.1 Në përputhje me paragrafin 8.2.1(d) të **Rregullave të Tregut**, niveli minimal i **Garancionit Financiar** të një **Tregtari Ndërkufitar** do të jetë zero, sepse pritet që:

- (a) **Nominimet në Interkonektor** do të jenë të mbështetura me garancione të mjaftueshme për shfrytëzimin e Interkonektorëve;
- (b) Një përpjesë e ndjeshme e rrjedhave të energjisë në **Interkonektor** janë për nevoja të transitit dhe nuk do të shkaktojnë rrezik për balancimin në Kosovë; dhe
- (c) importi për shitje tek **Furnizuesit** në Kosovë shpesh bënë bartjen e këtyre rreziqeve për jobalanc tek këta **Furnizues**, të cilët duhet të sigurojnë **Garancionin Financiar** sipas **Rregullave të Tregut**.


4 Format e Deponimit të Garancionit Financiar

4.1 Format e Pranueshme të Garancionit Financiar

4.1.1 Në përputhje me paragrafin 8.3.1 të **Rregullave të Tregut**, format e pranueshme të instrumenteve të **Garancionit Financiar**, do të jenë:

- (a) parat e gatshme;
- (b) **garancionet e parevokueshme bankare**;

4.1.2 Asgjë nuk e kufizon numrin e instrumenteve të **Garancionit Financiar**.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 10 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

4.2 Trajtimi i depozitave në para të gatshme

4.2.1 Në qoftë se një **Palë Tregtare** deponon para të gatshme si formë e **Garancionit Financiar**, **OT** do të regjistroj këtë shumë të parave të gatshme në **Regjistrin e Garancionit Financiar**, mjetet e deponuara do të mbahen në një Llogari Mirëbesimi në bankën në të cilën janë deponuar këto mjete, detajet e së cilës janë dhënë në Shtojcën 1 të cilat **OT** mund të tërheq vetëm në përputhje me nenin 7.

4.2.2 Paratë e gatshme duhet të deponohen në Euro.

4.2.3 Përveç si specifikohet në nenin 6, depozitat e parave të gatshme nuk mund të tërhiqen nga ana e një **Pale Tregtare**.

4.3 Garancionet Financiare

4.3.1 Një **Palë Tregtare** mund të dorëzoj një **garancion financiar** në Euro si një formë e **Garancionit Financiar** të tij, që duhet të bëhet në favor të **OT** dhe që do të përpilohet në formën e specifikuar në Shtojcën 2.

4.3.2 **Garancioni financiar** mund të jetë nga një bankë në Kosovë ose nga një bankë e jashtme, por në qoftë se është një bankë e huaj, **Pala Tregtare** duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme **OT** që rregullat që administrojnë entitetin përkatës në shtetin e saj të regjistrimit nuk përjashtojnë obligimin e nënkuptuar në garancion.

4.3.3 **Garancioni financiar** do të mbetet valid si **Garancion Financiar** nëse institucioni bankar ka një vlerësim [B+] ose institucioni bankar është i licencuar në Kosovë.

4.3.4 **Garancioni financiar** i dorëzuar nga një **Palë Tregtare** nuk mund të tërhiqet gjatë periodës së validitetit.

4.3.5 2 muaj kalendarik para skadimit të një **garancioni financiar**, **OT** do ta njoftoj **Palën Tregtare** të përfshirë që ta bëjë zëvendësimin e **garancionit financiar** me një instrument të **Garancionit Financiar** por nuk do të ndërmerri ndonjë veprim tjetër në lidhje me skadimin që pritet.

5 Monitorimi i nivelit të Garancionit Financiar


5.1 Ri-kalkulimi i nivelit minimal të Garancionit Financiar

5.1.1 Përkundër kalkulimeve të bëra çdo Tetor në përputhje me nenin 3, **OT** mund të bëjë ri-kalkulimin e nivelit minimal të **Garancionit Financiar** të kërkuar nga një ose më shumë **Palë Tregtare** kur:

(a) **Çmimi Sigurues i Jobalancit** është ndryshuar në përputhje me paragrafin 3.1.3; ose

(b) **OT** kupton që:

- (i) përqindja minimale e jobalanceve negative të caktuar në përputhje me paragrafin 3.2.1 rezulton me nivel minimal të **Garancionit Financiar** për një ose më shumë **Palë Tregtare**, që paraqet më pak se totali mujor i **Pagesave për Jobalancet** të cilat duhet ti mbuloj **Garancioni Financiar**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 11 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (ii) përpjesa e kalkuluar në përqindje e konsumit vjetor të energjisë elektrike që i atribuohet një Furnizuesi është për [10%] më e madhe se niveli i kalkuluar (në vitin) paraprak;
- (iii) që cila do nga: faktori i fuqisë së gjeneratorit, Kapaciteti i Rrjetit për Prodhuesin ose përpjesa e energjisë vjetore e jobalancit negativ të Prodhuesit është rritur për [10%] ose më shumë.

5.2 Monitorimi i Garancionit Financiar

5.2.1 OT do të realizoj monitorimin ashtu si është specifikuar në paragrafin 8.4 të **Rregullave të Tregut**.

6 Veprimet për ndryshimin e Vlerave të Garancionit Financiar

6.1 Ri-kalkulimet vjetore

6.1.1 Pas kalkulimit vjetor të vlerave minimale të **Garancionit Financiar** të specifikuar në nenin 3, **OT** do të njoftoj çdo **Palë Tregtare** me vlerën e saj minimale të reviduar.

6.1.2 Kur **Garancioni Financiar** i një **Pale Tregtare** nuk është adekuat, kjo **Palë Tregtare** do të jetë përgjegjëse për të ofruar instrumente të mjaftueshme të **Garancionit Financiar** për të arritur së paku vlerën minimale të **Garancionit Financiar**.

6.1.3 Kur **Garancioni Financiar** i një **Pale Tregtare** është më i lartë se vlera minimale e **Garancionit Financiar** të kërkuar në fillim të vitit, atëherë **Pala Tregtare** mund të aplikoj për korrigjimin e një ose më shumë instrumenteve të **Garancionit Financiar** në përputhje me paragrafin 6.2.

6.2 Aplikimi i Palës Tregtare për korrigjimin e instrumenteve të Garancionit Financiar


6.2.1 Në çdo kohë një **Palë Tregtare** mund të aplikoj për korrigjim të instrumenteve të **Garancionit Financiar** duke parashtruar një **Njoftim** me shkrim tek **OT** së paku një muaj më herët se data për të cilën kërkohet korrigjimi.

6.2.2 **OT** do të pranoj një njoftim për korrigjimin e një ose më shumë instrumenteve të **Garancionit Financiar** me kusht që, në datën e korrigjimit **Pala Tregtare** të vazhdoj të mirëmbaj së paku vlerën minimale të **Garancionit Financiar** të kalkuluar për atë **Palë Tregtare**.

6.3 Korrigjimi i Instrumenteve të Garancionit Financiar

6.3.1 Kur **OT** pranon të bëhet korrigjimi i një instrumenti të **Garancionit Financiar**, atëherë në të parën **Ditë Pune** që mund të jetë para ose pas datës në **Njoftimin** për korrigjim ose data e tërheqjes në rastin e **Palës në Tërheqje**, **OT** do të:

- (a) Verifikoj që instrumenti i **Garancionit Financiar** mbetet në fuqi dhe nuk është tërhequr në përputhje me nenin 7;
- (b) në rast të **garancionit financiar**, kthimin e instrumentit **Palës Tregtare** (me kusht që ai nuk ka qenë i tërhequr më parë);
- (c) në rast të depozitimit në para të gatshme, kthimin e shumës së kërkuar të parave të gatshme **Palës Tregtare** (përveç nëse parat e gatshme tashmë janë tërhequr); dhe
- (d) në rast të ndryshimit të garantuesit, të bëjë regjistrimin e ndryshimeve në **Regjistrin e Garancionit Financiar**;

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 12 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

dhe do të bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme në **Regjistrin e Garancionit Financiar**.

6.4 Tërheqja e një Pale Tregtare

6.4.1 Kur një **Palë Tregtare** bëhet **Palë në Tërheqje**, në **Datën e Tërheqjes OT** do t'ia kthej **Palës në Tërheqje** të gjitha instrumentet e **Garancionit Financiar** që nuk janë tërhequr në përputhje me nenin 7, për evitimin e dyshimeve, kjo do të jetë data në të cilën do të kryhen të gjitha detyrimet financiare të **Palës Tregtare** sipas **Rregullave të Tregut**.

7 Tërheqja e Garancionit Financiar

7.1 Të drejtat e OT


7.1.1 Në çdo kohë kur një **Palë Tregtare** dështon të paguaj vlerat e faturave për **Llojet e Pagesave në Faturat** vijuese:

- (a) **Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Tregut;**
- (b) **Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Sistemit**
- (c) **Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Sistemit;**
- (d) **Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Tregut**
- (e) **Detyrimi i Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit**
- (f) **Totalin mujor të Pagesave nga Ofertat për Blerje/Shitje;**
- (g) **Vlerën totale mujore të Pagesave të Jo-Liferimit;**
- (h) **Vlerën totale mujore të Pagesave të Jobalanceve:**
- (i) **Vlerën totale mujore të pagesave të Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse për mbulimin e Humbjeve, dhe Rezervës;**
- (j) **Vlerën totale të Pagesave nga Llogaria Balancuese e OST;**
- (k) **Pagesat Mujore pas Korrigjimit të Matjeve;**
- (l) **Pagesat e Furnizuesit për Fondin Mbështetës për BRE; dhe**
- (m) **Pagesat e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE.**

OT, ka të drejtë të përzgjedhë një ose më shumë instrumente të **Garancionit Financiar** të deponuara nga **Pala Tregtare** dhe të mbuloj borxhin deri në vlerën totale të mbuluar me instrumentet e **Garancionit Financiar**.

7.1.2 OT do të regjistroj aktivitetet e veta në tërheqjen e instrumenteve të Garancionit Financiar dhe do të regjistroj zvogëlimin e vlerës së Garancionit Financiar të Palës Tregtare të ndikuar.


7.1.3 Kur OT tërheq instrumentet e Garancionit Financiar, OT do ta njoftoj Palën Tregtare të ndikuar dhe kur është e nevojshme, do të kërkoj zëvendësimin e instrumenteve të Garancionit Financiar që janë tërhequr.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 13 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

8 Pasoja e mos-mbajtjes së Garancionit adekuat nga Pala Tregtare

8.1 Shkelja materiale

8.1.1 Dështimi për të mbajtur **Garancionin Financiar** adekuat është shkelje materiale e dispozitive materiale të **Rregullave të Tregut** dhe do të trajtohet në përputhje me paragrafin 3.5.1 të **Rregullave të Tregut**.


	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 14 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

SHTOJCA 1

Rregullat në lidhje me Llogarinë e Mirëbesimit

Në rastet kur **Pala Tregtare** ofron para të gatshme si Garancion Financiar në favor të **OT**, atëherë **Pala Tregtare** duhet që:

1. Paratë e gatshme ti deponojë në ndonjë bankë.
2. Banka duhet të hap një Llogari Mirëbesimi në të cilën deponohen parat e gatshme.
3. Banka këto mjete të **Palës Tregtare** në shumën e **garancionit financiar** i bllokon përderisa garancioni është valid.
4. Nëse **OT** në bazë të nenit 7 kërkon ti tërheq këto mjete, atëherë banka ka të drejtë ti përdor këto mjete të bllokuara për ti kryer obligimet në rastin kur **Pala Tregtare** dështon ti përmbush detyrimet e sajë.
5. **Pala Tregtare** sipas rregullave të bankave nuk ka qasje në Llogarinë e Mirëbesimit.
6. Rregullat dhe kushtet e hapjes së Llogarisë së Mirëbesimit i përpilon banka, varësisht nga kërkesat e **OT** të përcaktuara në këtë procedurë.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 15 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

SHTOJCA 2

Forma e garancionit bankar

Drafti i Garancionit të Pagesës

Jemi njoftuar se, _____ (Emri dhe adresa e përfituesit) _____ (në tekstin e mëtutjeshëm "Përfituesi") keni lidhur një kontratë me nr. _____ (numri i kontratës) _____ më datën _____ me _____ (Emri dhe adresa e aplikantit) _____ (në tekstin e mëtutjeshëm "Aplikanti") ne lidhje me furnizimin e _____ (emërtimi i mallit) _____.

Për pagesën me kohë të obligimeve të mallrave të liferuara dhe shërbimeve të ofruara, ju kërkoni të siguroheni me garancion bankar.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, në, _____ (emri i institucionit bankar). (në tekstin e mëtutjeshëm "Banka") në mënyrë të parevokueshme dhe pa asnjë kushtëzim garantojmë të ju paguajmë, dhe pa të drejtë kundërshtimi nga kontrata e lartpërmendur me pranimin e kërkesës suaj të parë me shkrim çfarëdo shume të cekur në kërkesë por që nuk tejkalon në asnjë rast shumën prej

_____ (shuma e garancionit) _____ (_____ (shuma e garancionit ne fjale) _____) Brenda afatit prej 7 ditëve pas pranimit të kërkesës suaj për pagesë, në llogarinë e caktuar nga ju.

Kërkesa juaj duhet të cekë se:


Ju, _____ (Emri dhe adresa e përfituesit) _____, keni furnizuar _____ (Emri dhe adresa e aplikantit) _____ me _____ (emërtimi i mallit) _____ në pajtim me kushtet e kontratës me nr. _____ te datës _____

DHE

_____ (Emri dhe adresa e aplikantit) _____ ka dështuar në pagesën e obligimeve nga kontrata me nr. _____ të datës _____ i.e. _____ ditë nga data e faturës/datës së ngarkimit.

Kërkesa për pagesë duhet të shoqërohet me garancionin origjinal (dhe amendamentet nëse ka) si dhe kopjen e faturës së papaguar të mallit të nënshkruar dhe vulosur nga aplikuesi dhe përfituesi të cekur me lartë.

Shuma e garancionit do të reduktohet/zvogëlohet me secilën pagesë të kryer nga Banka nën këtë garancion, me kërkesë të përfituesit.

	Procedura e Rregullave të Tregut për Garancionin Financiar	
	<i>vers. 1.1</i>	<i>Faqe 16 nga 16</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Ky garacion do të mbetet në fuqi deri më (data e skadimit) në 16:00 ora lokale në Kosovë dhe çdo kërkesë në lidhje me këtë garacion duhet të arrijë në bankë para kësaj date dhe ore. Pas kësaj date dhe ore ky obligim për pagesë bëhet i pavlefshëm, pa marrë parasysh a është dorëzuar garacioni në bankë apo jo.

Ky garacion i nënshtrohet Rregullave Uniforme për Garacionet me Kërkesë të Parë të Odës Ndërkombëtare Ekonomike, Paris Francë, Publikimi nr. 758 (URDG 758). (Emri i institucionit bankar)

Drafti i pranuar nga: (Emri, Mbiemri, nënshkrimi i personit të autorizuar, vula dhe data)
